

QYTETARI DHE PSIKOLOGJI

Varianti A

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Qytetari

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 9	D	1 pikë
Pyetja 10	B	1 pikë
Pyetja 11	A	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë

Pyetja 5

3 pikë

Model përgjigjeje

- a) -parë.
- të drejtave civile.
-të drejtave politike.

- b) Qëndrimi:

(Pro)

-Respektimi i masave kufizuese dhe shtrënguese për shkak të situatës së Covid-19, minimizon rrezikun e infektimit duke siguruar të drejtën e shëndetit dhe jetës. E drejta e jetës dhe shëndetit në këtë rast ka epërsi ndaj të drejtës së protestës. Për këtë arsye e konsideroj të drejtë vendimin e policisë për respektimin e protokollit të sigurisë.

-Kufizimi i disa të drejtave në kushte të jashtëzakonshme, vendosen me ligj për çështje të interesit publik, ose mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Për aq kohë sa këto masa janë përcaktuar të jenë kufizuese si pasojë e vlerësimit të gjendjes nga grupi i specialistëve, vendimi i policisë mendoj se është i drejtë, pasi ata janë zbatues të ligjit.

-Etj.

(Kundër)

-Qytetarët ndihen të sigurt pasi janë vaksinuar ose imunizuar ndaj virusit, për këtë arsye reagimi i policisë nuk është i drejtë. Në këto kushte grumbullimi i tyre për të ushtruar të drejtën e protestës nuk rrezikon shëndetin.

-Qytetarët po ushtrojnë të drejtën e protestës në ambiente të hapura ndaj risku për infektim është mjaft i ulët ose nuk ekziston. Protokollet e sigurisë duhet të rishikohen duke vlerësuar numrin e të vaksinuarve dhe numrin e rasteve të infektiveve në mënyrë që të mundësojë të drejtën e protestës.

-Çdo qytetarë duhet të jetë i lirë të vendos vetë për mënyrën e ruajtjes së shëndetit të tij dhe të shpreh pa kufizim qëndrimin duke ushtruar të drejtën e protestës. Për këtë arsye mendoj se qëndrimi i policisë nuk është i drejtë.

-Etj.

- 3 pikë nëse përcakton kategorinë dhe argumenton qëndrimin;
Ose
2 pikë nëse argumenton qëndrimin; nëse përcakton kategorinë dhe ka nisur
OSE argumentin pa e përfunduar;
ose
1 pikë nëse përcakton kategorinë dhe ka nisur argumentin pa e përfunduar;
0 pikë nëse përcakton kategorinë ose ka nisur argumentin pa e përfunduar;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 6

2 pikë

Model përgjigjeje

- Situata e pandemisë ose rreziku nga terrorizmi përbën një gjendje emergjence dhe të jashtëzakonshme ndaj kufizimi i disa të drejtave në të tilla raste të veçanta, është i justifikuar për mbrojtjen e rendit publik (mirëqenies së përgjithshme).
- Në situatën e pandemisë ose rrezikut nga terrorizmi justifikohet kufizimi i disa të drejtave për mbrojtjen e sigurisë publike.
- Në situatën e emergjencës për shkak të pandemisë ose rrezikut të terrorizmit kufizimi i disa të drejtave justifikohet për të mbrojtur shëndetin dhe jetën.
- Kufizimi që bazohet në respektimin e lirisë së tjetrit. Disa të drejta kufizohen për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Në periudhën e pandemisë të gjithë mund të ishin potencial transmetimi ose infektimi ndaj një kufizim i tillë është i justifikuar.
- Etj.

- 2 pikë nëse shpjegon dy arsye;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një arsye;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 7

2 pikë

Model përgjigjeje

- Aplikimi i shprehive praktike të njohurive që nxënësit kanë mësuar teorikisht. Organizimi aktiviteteve sociale janë një zbatim i atyre aspekteve që nxënësit kanë mësuar teorikisht në lëndët sociale.
- Shoqërizimi është proces i pandërprerë që ndodh nga ndërveprimi me të tjerët dhe në këtë rast këto aktivitete sociale të përbashkëta zhvillojnë aftësitë sociale dhe ndihmojnë në formësimin e identitetit.
- Aktivitetet sociale ndihmojnë në formimin e shprehive si zhvillimi i aftësive organizative, të mendimit krijues, të mendimit kritik, etj.
- Aktivitete të tilla nxisin e kultivojnë zhvillimin e talenteve, aftësive duke i promovuar nxënësit në aftësitë që kanë.
- Aktivitete të tilla sociale ndikojnë në transmetimin e normave dhe vlerave kulturore të shoqërisë.
- Integrimi shoqëror i nxënësve të ndryshëm, pavararësisht aftësisë në aktivitete të përbashkëta, duke nxitur bashkëpunimin.
- Etj.

2 pikë nëse shpjegon dy funksione;
OSE

1 pikë nëse shpjegon një funksion;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 8

2 pikë

Model përgjigjeje

- Parandalimi është i rëndësishëm pasi nënkupton një strategji që ul mundësinë e rrezikut për zhvillimin e sëmundjes. Kujdesi që tregojmë për veten nëpërmjet një regjimi ushqimor, aktiviteteve sportive, sociale etj., ndikojnë në një stil jetese më të përshtatshëm.
- Parandalimi është i rëndësishëm për të ulur kostot për shëndetin. Nëpërmjet vendimeve për një stil më të përshatshëm jetese ne mund të ndikojmë në një kontroll më të madh mbi gjendjen e shëndetit.
- Parandalimi është i rëndësishëm pasi ul kostot financiare. Trajtimet në kushtet e zhvillimit të sëmundjes kanë kosto më të lartë nga pikëpamja e shpenzimeve financiare.
- Etj.

2 pikë nëse shpjegon dy arsye;
OSE

1 pikë nëse shpjegon një arsye;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12

3 pikë

- Shitësi ose prodhuesi ka detyrimin t'i ofrojë konsumatorit pa pagesë shtesë, rimbursim të çmimit të paguar nëse nuk mund të zëvendësoj mallin. Në këtë rast përfiton nga garancia pasi është brenda afatit dyvjeçar.

- Shitësi ose prodhuesi ka detyrimin t'i ofrojë konsumatorit pa pagesë shtesë, zëvendësim të mallit, pra të jap një tjetër telefon celular pa defekt.
- Shitësi ose prodhuesi ka detyrimin t'i ofrojë konsumatorit pa pagesë shtesë, riparim të mallit, të përputhshëm me karakteristikat e produktit të shitur, në këtë rast celulari.

3 pikë OSE	nëse shpjegon tre mundësitë e përfitimit;
2 pikë OSE	nëse shpjegon dy mundësitë e përfitimit;
1 pikë	nëse shpjegon një mundësi të përfitimit;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetje 13

3 pikë

Model përgjigjeje

1. Pasoja fizike – ligjërshyt ky aktivitet nuk mund të lejohet për moshën 15 vjeçare. Puna në grumbullimin e komit për këtë moshë dhe me kohëzgjatje, pengon rritjen dhe zhvillimin fizik, mund të sjell mbilodhje, ulje të rezistencës etj, të cilat mund të shkaktojnë sëmundje të ndryshme. Fakti që aktiviteti i punës realizohet në një zonë me mundësi aksidenti përbën kërcënim për jetën.
2. Pasoja sociale- në këtë aspekt fëmija nuk kalon fazat e zhvillimit në socializim me bashkëmoshatarët. Në këtë moshë Edliri po humbet mundësinë për t'u arsimuar dhe realizuar aktivitete që do të ndikonin në formimin e shprehive dhe mirëqenien sociale.
3. Pasoja psikologjike- presioni, stresi, pagjumësia ose ankthi psikologjik që lidhet me fitimin e të ardhurave nga veprimtaria që ushtron pasi është i vetmi burim i të ardhurave në familje. Zhvillimi i një koncepti për veten pa mundësinë e perspektivës, mund të shoqërohet me ndjenjën e inferioritetit. Për shkak të peshës së përgjegjësisë Edliri duket se është rritur përpara kohe.

3 pikë OSE	nëse argumenton tre pasoja;
2 pikë OSE	nëse argumenton dy pasoja;
1 pikë	nëse argumenton një pasojë;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 16

2 pikë

Model përgjigjeje

- Ermira nuk ka të drejtë të kalojë.
- Sinjalet me dorë të policit të trafikut kanë përparësi dhe shfuqizojnë gjithë sinjalet e tjera. Në këtë situatë roli i semaforit nuk është përcaktues. Ermira duhet të orientohet nga drejtimi që përcakton polici rrugor.

2 pikë OSE	nëse përcakton se nuk ka të drejtë dhe e shpjegon;
----------------------	--

1 pikë nëse përcakton se nuk ka të drejtë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17

3 pikë

Model përgjigjeje

- Informim dhe përditësim me lajme të fushave të ndryshme të interesit publik: ekonomik, politik, social, kulturor, etj.
- Analiza historike, të aktualitetit dhe perspektivës në fusha të ndryshme (ekonomike, politike, sociale, etj.).
- Njohje me kulturat e ndryshme, shkëmbim përvojash, traditash.
- Rritje e vetëdijes shoqërore për angazhim solidar.
- Vlerësim kritik i aktualitetit në aspektin politik, ekonomik, etj.
- Publikimi i lirë dhe i pavarur i lajmeve, ideve, etj. që përbëjnë një element të rëndësishëm për një shoqëri demokratike.
- Prezantim i lajmeve duke respektuar paanësinë, për të transmetuar ngjarjet, faktet siç kanë ndodhur.
- Publikim i lajmeve pa censurë, por duke rregulluar veprimtarinë sipas parimeve të kodit të etikës në media (respektimi i privatësisë, përdorimi i një gjuhe të përshtatshme, etj.).
- Mënyrë argëtimi nëpërmjet programeve të caktuara.
- Etj.

3 pikë nëse përcakton tre funksione;
0SE

2 pikë nëse përcakton dy funksione;
0SE

1 pikë nëse përcakton një funksion;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Psikologji

Pyetja 20	D	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë
Pyetja 22	D	1 pikë
Pyetja 27	D	1 pikë
Pyetja 28	B	1 pikë
Pyetja 31	C	1 pikë
Pyetja 32	A	1 pikë
Pyetja 33	D	1 pikë
Pyetja 34	A	1 pikë
Pyetja 35	B	1 pikë

Pyetja 19

3 pikë

Model përgjigjeje

- Për drejtimin bihevjorist sjellja e njeriut përcaktohet nga kërkesa e mjedisit ku ai jeton e ndërvepron.
- Psikologjia e drejtimit bihevjorist studion vetëm sjelljet e jashtme, ato sjellje që mund të vëzhgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- Drejtimi bihevjorist studion sjelljet e dukshme të cilat mund të maten objektivisht.
- Proceset mendore janë veprimtari të brendshme dhe nuk mund të vëzhgohen e maten në mënyrë shkencore, ndaj nuk duhet të jenë objekt i studimit të psikologjisë.

3 pikë	nëse përcakton tre aspekte;
OSE	
2 pikë	nëse përcakton dy aspekte;
OSE	
1 pikë	nëse përcakton një aspekt;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23

3 pikë

Model përgjigjeje

- 1) Hormoni që sekretohet është adrenalina (epinefrinë).
- 2) Shpjegimi i plotë
 - Gjëndra mbiveshkore bëhet aktive sepse Erblini ndihet i frikësuar. Sekretimi i adrenalines aktivizon sistemin nervor simpatik që e përgatit për urgjencat dhe nga ky sekretim çlirohet më shumë energji për të përballuar situatën.
Ose
 - Sekretimi i adrenalines dhe noradrenalines ndikon në rritjen e rrahjeve të zemrës dhe në shpeshtim të frymëmarrjes. Lidhet kryesisht me ndjenjën e frikës, ankthit. Ky sekretim ndikon që tek Erblini të çlirohet më shumë energji për të përballuar situatën në të cilën ndodhet.

Shpjegimi i pjesshëm

- Gjëndra mbiveshkore bëhet aktive sepse Erblini ndihet i frikësuar.
Ose

- Sekretimi i adrenalines aktivizon sistemin nervor simpatik qe e pergatit per urgjencat.
- Nga sekretimi i adrenalines çlirohet me shume energji per te perballuar situaten.

Ose

- Sekretimi i adrenalines dhe noradrenalines ndikon ne rritjen e rrahjeve te zemres dhe ne shpeshtim te frymëmarrjes.

Ose

- Lidhet kryesisht me ndjenjen e frikes, ankthit.

Ose

- Ky sekretim ndikon qe tek Erblini te çlirohet me shume energji per te perballuar situaten ne te cilen ndodhet.

3 pikë nëse përcakton hormonin dhe jep shpjegimin e plotë;

OSE

2 pikë nëse përcakton hormonin dhe jep shpjegim të pjesshëm;

OSE

1 pikë nëse përcakton hormonin;
nëse shpjegon pjesërisht.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24

2 pikë

Model përgjigjeje

- Shqetësimet e përditshme- janë stresorët më të vegjël të jetës së përditshme, të cilët në vetvete nuk janë shumë të rëndësishëm, madje mund të jetë edhe rutina e përditshmërisë, por kur grumbullohen mund të bëhen burime të mëdha stresi. (Shembull: pas një përgatitje të gjatë, një nxënës, për një pikë, nuk arrin të marri 10 në test; etj.)
- Frustrimi- është një gjendje emocionale negative që në përgjithësi shoqërohet me pengesë në arritjen e qëllimit. Në këto kushte mund të heqim dorë nga qëllimi ose të gjejmë shtigje të tjera për realizimin e qëllimit.
- Konflikti- lind kur detyrohemi të bëjmë një zgjedhje mes dy ose më tepër alternativave që janë të papajtueshme me njëra-tjetrën.
- Ngjarjet katastrofike- ngjarjet si tërmeti, përmbytjet, aktet terroriste, erozioni, etj. janë ato që psikologët i quajnë ngjarje katastrofike, ngjarje të tilla mund të shërbejnë si stresorë.
- Presioni- mund të jetë i brendshëm, si kërkesë ndaj vetes ose mund të jetë i jashtëm që lidhet me kërkesat që parashtrajnë prindërit, mësuesit etj.

2 pikë nëse shpjegon dy grupe stresorësh;

OSE

1 pikë nëse shpjegon një grup stresorësh;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25

2 pikë

Model përgjigjeje

Strategjia e orientuar nga deyra:

- Kryerja e veprimeve që pakësojnë stresin. Është e rëndësishme që njeriu në këtë gjendje të orientohet për të tejkaluar këtë situatë duke përdorur mënyra të caktuara më efektive.

- Parashikimi i veprimeve. Orientimi dhe inkurajimi ndaj veprimeve më të dobishme për t'u çliruar nga stresi. Një njeri i stresuar ndoshta nuk arrin të realizojë veprimet e nevojshme, ndaj nevojitet nxitja për aktivitete dhe nevoja për prezencë përgjatë kësaj kohe.
- Vlerësimi i suksesit të arritur. Angazhimi në veprimtari të cilat largojnë stresin dhe nevoja e vlerësimit të arritjeve.
- Etj.

Strategjia e orientuar nga mbrojtja:

- Fokusimi në diçka tjetër që na pëlqen të angazhohemi, sa për t'u shkëputur pak.
- Realizimi i në një veprimtari tjetër. Ky lehtësim nga stresi do të jetë i përkohshëm.

Strategjia e fokusuar te problemi:

- Në këtë rast menaxhimi i situatës do të ishte të "vinim punën përpara", duke filluar më herët përgatitjen.
- Hartimi i një plani pune paraprak do të ndihmonte në një situatë të tillë.
- Mbajtja e shënimeve dhe realizimi i provave në prezantim për t'u praktikuar përpara miqve, të afërmve, mësueseve, etj., mund të jetë ndihmuese për të marrë këshilla të dobishme.

Strategjia e përqendruar tek emocioni:

- Përdorimi i disa teknikave të caktuara për të reduktuar dhe menaxhuar ankthin, emocionet.
- Teknika e relaksimi progresiv i muskujve duke shtrënguar dhe liruar disa prej tyre.
- Teknika e frymëmarrjes së thellë, duke përdorur diafragmën për të bërë frymëmarrje të ngadalta dhe të thella.
- Teknika e imagjinatës së drejtuar na ndihmon të përdorim imagjinatën për t'u "arratisur" në një vend që na sjellë qetësi e lumturi.

Strategjia mbështetëse:

- Duke marrë në konsideratë parashikimet e mundshme për situatën, do të jemi më të hapur për të pranuar edhe situatat e dështimit.
- Rekomandimi i disa veprimeve të caktuara që lidhen me situatën.
- Kur e dimë se kemi mbështeje për të përballuar situatat stresante, marrim më shumë motiv dhe energji për t'ja dalë mbanë.
- "Vaksinimi" është një tjetër teknikë që ndihmon për të rritur besimin ndaj rezultateve pozitive.

Etj.

2 pikë	nëse argumenton dy strategji;
OSE	
1 pikë	nëse argumenton një strategji;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26

2 pikë

Model përgjigjeje

- Të nisemi nga pikat tona të forta, të gjërave që dimë të bëjmë më mirë, kjo na bën të ndihemi krenarë dhe na motivon.
- Të mësojmë të duam dhe vlerësojmë veten, që të tjerët të na vlerësojnë dhe respektojnë.
- Të pranojmë veten ashtu siç jemi, duke njohur edhe anët e mira edhe pikat e dobëta.
- Të kuptojmë se të gjithë njerëzit gabojnë dhe të përballemi me gabimet tona.
- Të vendosim kontroll mbi jetën tonë dhe të marrim në duar fatin tonë.
- Të mos lejojmë të tjerët të ndërhyjnë në zgjedhjet tona personale.
- Të jemi të përgjegjshëm dhe t'i marrim vendimet bazuar në prirjet dhe dëshirat tona.
- Të mësojmë nga njerëz të suksesshëm dhe pozitivë.

- Të përqipemi të bëjmë gjëra të reja, interesante, krijuese, që të falin kënaqësi.
- Mos të krahasohemi me të tjerët.
- Të zhvillojmë pritshmëri realiste.
- Etj.

2 pikë nëse shpjegon dy mënyra;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një mënyrë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 29

2 pikë

Model përgjigjeje

- Ndërveprimi me të rriturit- roli i familjes është primari në formimin e tipare të karakterit dhe personalitetin e individit. Psikologët shpjegojnë se mungesa e dashurisë dhe kujdesit prindëror sjell te fëmija për pasojë zhvillimin e ndjenjave të mosbesimit dhe frikës, inferioritetit dhe mungesës së vetëbesimit e motivacionit për të qenë i suksesshëm dhe vullnetit për të çuar deri në fund zgjedhjet e tyre.
- Ndërveprimi me bashkëmoshatarët- roli i moshatarëve është i rëndësishëm në formimin e vetes dhe konceptit për të. Grupet e moshatarëve ushtrojnë ndikim të veçantë sidomos tek adoleshentët, sepse me ta e ndjejnë veten të çliruar nga detyrimet dhe ndjehen të barabartë. Ata flasin për çështje, të cilat nuk mund t'i diskutojnë me mësuesit ose prindërit: për modën e veshjes dhe shijet muzikore, për problemet e seksit, të drogës etj. Brenda grupeve të tilla fëmijët, të rinjtë kanë pavarësi të dukshme, e cila u jep mundësi të krijojnë marrëdhënie shoqërore dhe të pohojnë personalitetin e vet, pavarësisht nga familja.

2 pikë nëse analizon dy faktorë;
OSE
1 pikë nëse analizon një faktor;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30

3 pikë

Model përgjigjeje

- Janë fragmentare, shpesh kaotike, të paorganizuara, meqënëse veprimtaria e trurit në gjumë është e pavetëdijshme;
- Janë pasqyrim i ndryshuar dhe shpesh i deformuar i realitetit, në kohë dhe në hapësirë;
- Janë të shumta dhe të larmishme, shpesh të çuditshme dhe të pashpjegueshme, kjo varet nga natyra emocionale dhe imagjinata e gjithsecilit;
- Janë ndijime, imazhe (pamore, dëgjimore dhe të prekjes), mendime, emocione që përjetoohen gjatë gjumit;

- Zgjasin nga pak sekonda në disa minuta dhe ndodhin kryesisht gjatë gjumit me LSHS, të cilat mbahen mend më mirë dhe riprodhohen lehtësisht; nëse shihen gjatë gjumit të thellë mbahen mend më pak dhe kanë më pak natyrë pamore dhe në formën e mendimeve të pastrukturuara;
- Përmbajtja e ëndrrave varet nga natyra dhe shkaku i saj, që mund të jetë me bazë fiziologjike, emocionale, sociale dhe psikologjike etj.

3 pikë OSE	nëse përshkruan tri karakteristika;
2 pikë OSE	nëse përshkruan dy karakteristika;
1 pikë	nëse përshkruan një karakteristikë;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 36

3 pikë

Model përgjigjeje

- 1)
 - Diskriminim
- 2)
 - Përbërësi emocional- Në mentalitetin e punonjësve të medias angazhimi politik i një gruaje, në këtë rast Borës nuk krijon besim. Punonjësit e medias ashtu sikurse familjarët dhe miqtë e saj nuk e mbështesin meqenëse mungon besimi për të kryer këtë punë të konsideruar për burra, duke i vlerësuar ata për aftësi në drejtim.
 - Përbërësi mendor- Në mentalitetin e punonjësve të medias vepron me përparësi mendësia se përfshirja në politikë është punë burrash, gratë nuk mund ta realizojnë atë në mënyrën e duhur, pasi u mungon aftësia në drejtim. Kjo mendësi udhëhiqet nga stereotipat dhe paragjykimi për rolin e gruas në politikë, në këtë rast Borës. Një mendësi e tillë profilizon gruan më afër disa profesioneve të caktuara, që nuk ka rol të madh në vendimmarrje, por që kërkojnë përkujdesje, etj. Për këtë arsye profesionin e mësueses e shohin më të përshtatshëm për gratë.
 - Përbërësi sjellor- Mënyra e të menduarit sipas logjikës ndarëse përsa i përket gjinisë, që konsideron burrat më të aftë në politikë, ndërsa gratë jo të përshtatshme për këtë angazhim, bën që media të shfaqet diskriminuese duke mos e ftuar Borën në emisione përgjatë fushatës elektorale.
Media nuk e sheh kandidaturën e Borës si grua, me potencial për të rivalizuar suksesshëm në zgjedhje duke e diskriminuar, për këtë arsye konsumon kohën televizive me kandidatë të tjerë.

3 pikë OSE	nëse përcakton dhe argumenton dy element të qëndrimit të medias;
2 pikë OSE	nëse përcakton dhe argumenton një element të qëndrimit të medias; nëse argumenton dy element të qëndrimit të medias;
1 pikë	nëse përcakton; nëse argumenton një qëndrim;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
